

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA” –
PRISHTINË**



**FAKULTETI JURIDIK
MASTER E DREJTA PENALE
PUNIM DIPLOME**

**“Shqiptimi i dënimit me kusht në territorin e Gjykatës Themelore Gjakovë-
Dega në Malishevë gjatë periudhës kohore 2018-2022”**

Mentori/ja:

Prof.Dr. Azem Hajdari

Kandidati/ja:

Alberitë Bibaj

Prishtinë, 2024

ABSTRAKT

Ndëshkueshmëria e kryersve të veprave penale ka qenë e ndryshme në periudha të ndryshme, varësisht nga zhvillimi i shoqërisë njerëzore. Duke filluar nga dënimet e rënda trupore të cilat kishin për qëllim hakmarrjen ndaj kryersve të veprave penale e deri tek dënimet më humane të cilat ekzistojnë sot. Ato parashihen me kode penale të secilit shtet e që kanë për qëllim ri-integrimin e ri- socilaizimin e kryersve të veprave penale, si dhe parandalimin e krimeve.

Mirëpo, nga dënimet të cilat shënojnë progresë të madhë në shoqërinë njerëzore, drejtë humanizimit të ndëshimeve penale janë dënimet alternative. Në dënime alternative bëjnë pjesë dënimi me kusht, gjysmëliria dhe urdhri për punë në dobi të përgjithshme.

Duke parë për së afërmi shqiptimin e shpesht të dënimit me kusht si dënim alternativ, kam ndjerë nevojën për studimin dhe hulumtimin e kësaj teme, për të ju ofruar lexuesve informacione lidhur me dënimin me kusht në aspektin, teorik dhe praktikë.

Mendimi se për vepra të lehta penale, të shqiptohen dënime më të lehta, gjenë vend në rastin e shqiptimit të dënimit me kusht. Sepse qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale. Ky dënim shqiptohet nga gjykata për një periudhë të caktuar kohore në rast se i dënuari nuk kryen vepër të re penale dhe i përmbush detyrimet të cilat i'a cakton gjykata. Mirëpo, në rast të mospërmbushjes së këtyre kushteve dhe nëse personi i dënuar kryen vepër të re penale ky dënim revokohet nga gjykata.

Kështu që në këtë punim të diplomës, do të trajtohen çështjet si në vijim: Çka nënkupton dënimi me kusht, procedura e shqiptimit të tij, llojet e tij, mënyra e revokimit, historiku, pjesa krahasuese me disa shtete të tjera përveç Kosovës, ana praktike e këtij dënimi e që është shqiptimi i tij në Gjykatën Themelore në Gjakovë- dega në Malishevë, etj.

Fjalët kyçe: Dënim me Kusht, Shqiptim, Revokim, Ekzekutim, Vepra penale, Numri i dënimeve, Kodi Penal, etj.